



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 508/13 Prot.

Tiranë, më 08/06/2015

VENDIM

“ Për rrëzimin e ankesës”

Nr. 35, datë 08/06/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesit/Z. dhe Qendra “Res Publica”, kanë depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 508 Prot., datë 26.05.2015, ndaj Autoritetit Publik/Rektoratit të Universitetit të Tiranës, me objekt “Refuzim për dhënie informacioni”, sipas së cilës pretendon se është cënuar në të drejtën e tij për informim. Ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 24/1/2/b të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, Z. në datë 27.04.2015 ka paraqitur pranë autoritetit publik/Rektoratit të Universitetit të Tiranës, kërkesën për informacion. Kërkuesi ka kërkuar t’i vihen në dispozicion kopje të dokumenteve, konkretisht:

1. Kopje të listës së rankimit të aplikantëve për çdo program doktore për vitin 2012-2013 nga komisionet ad hoc, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, dokumente që i janë vënë në dispozicion Këshillit të Profesorëve.
2. Bazën ligjore ku është bazuar Dekani i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, në mosdeklarimin si fituese në programin e doktoraturës të kandidatës . Arsyet që kandidatja është pranuar më vonë në programin e doktoraturës. Dokumentin që ka paraqitur më vonë kjo kandidatë për vërtetimin e çregjistrimit të saj nga doktore e Universitetit Bujqësor të Tiranës.
3. Kopje të vendimeve të Rektorit të Universitetit nr.1318/20 datë 04.07.2013, nr.1318/25 datë 15.07.2013, nr.1318/33 datë 12.11.2013.
4. Procesverbalin e Komisionit ad hoc të Departamentit të Kimisë, i cili i është përcjellë Fakultetit të Shkencave të Natyrës me shkresën nr.3594/7 datë 06.02.2015 (fakt që përmendet në vendimin e Rektorit të Universitetit të Tiranës nr. 17 datë 09.02.2015).

Nëse procesverbali përmban të dhëna personale kërkohen emrat e personave të përzgjedhur në bazë të kriterëve të përzgjedhjes.

5. Procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e personit fitues të propozuar nga Komisioni Ad Hoc.
6. Kopje të kontratës tip të lidhur në bazë të vendimit nr. 17 datë 09.02.2015 të Rektoratit të Universitetit të Tiranës.

Nga dokumentacioni bashkëlidhur ankesës rezulton se, kërkesa është trajtuar brenda afatit ligjor, konform nenit 15/1 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" nga Autoriteti Publik/Rektorati i Universitetit të Tiranës.

Pas vlerësimit të ankesës Komisioneri, me urdhrin nr.114, datë 28/05/2015, urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/Rektorati i Universitetit të Tiranës. Gjatë inspektimit koordinatori shpjegoi se informacioni i kërkuar, administrohet nga Autoriteti Publik, madje është vënë në dispozicion të kërkuarit me anë të shkresës nr.404/4 datë 18.02.2015, shkresës nr.4-k/1 datë 02.03.2015, shkresës nr.7-k/3 datë 02.04.2015 dhe shkresës nr.13-k/1 datë 11.05.2015.

Nga sqarimet e koordinatorit si dhe nga verifikimi shkresor, grupi i inspektimit konstatoi se:

1. Lidhur me kërkesën për kopje të listës së rankimit të aplikantëve për çdo program doktore për vitin 2012-2013 nga komisionet ad hoc, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, koordinatori e Autoritetit publik shpjegoi se kërkesa ka qenë e përsëritur dhe në asnjë rast nuk është refuzuar dhënia e informacionit vërtetuar kjo me shkresën nr. 4-k/1 datë 02.03.2015.
2. Lidhur me kërkesën për bazën ligjore ku është bazuar dekani i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, në mosdeklarimin si fituese në programin e doktoraturës të kandidatës dhe arsyet që kandidatja është pranuar më vonë në programin e doktoraturës, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 13-k/1 datë 11.05.2015.
3. Lidhur me kërkesën për kopje të vendimeve të Rektorit të Universitetit nr.1318/20 datë 04.07.2013, nr.1318/25 datë 15.07.2013 dhe nr.1318/33 datë 12.11.2013, koordinatori shpjegoi se nuk ekziston asnjë vendim me këto numra por materialet e kërkuara janë shkresa, dy prej të cilave (shkresa nr.1318/20 datë 04.07.2013 dhe shkresa nr.1318/25 datë 15.07.2013) i janë vënë në dispozicion kërkuarit ndërsa shkresa nr. 1318/33 datë 12.11.2013 nuk mund t'i vihet në dispozicion pasi përmban të dhëna personale të kandidatëve dhe nuk mund të jepet pa pëlqimin e tyre. Grupi i inspektimit ka verifikuar që ky sqarim i është komunikuar kërkuarit me shkresën nr. 13-k/1 datë 11.05.2015.
4. Përsa i përket kërkesës për Procesverbalin e Komisionit ad hoc të Departamentit të Kimisë, i cili i është përcjellë Fakultetit të Shkencave të Natyrës me shkresën nr.3594/7 datë 06.02.2015, Autoriteti publik me anë të shkresës nr. 13-k/1 datë 11.05.2015 ka shpjeguar se në arshivat e UT nuk gjenden shkresa me këto numra që të kenë të bëjnë me procedurat e pranimeve në doktoraturë në FSHN për vitin akademik 2012-2013.
5. Autoriteti Publik me anë të shkresës nr. 13-k/1 datë 11.05.2015 ka informuar kërkuarin se cilat janë procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e personit fitues të propozuar nga Komisioni Ad Hoc ndërsa për kopjen e kontratës tip të lidhur në bazë të vendimit nr. 17, datë 09.02.2015 të Rektoratit të Universitetit të Tiranës, kërkuari është sqaruar me shkresën nr. 13-k/1 datë 11.05.2015.

Pas vlerësimit të ankesës së Z. dhe përgjigjeve të dhëna nga Autoriteti Publik, Zyra e Komisionerit konstaton se Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje për të gjitha kërkesat e bëra nga Z.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se ankesa rezulton e pa bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën e) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

V E N D O S A:

1. Rrëzimin tërësisht të ankesës nr. 508 Prot., datë 26.05.2015 të Z. kundër Autoritetit Publik/ Rektoratit të Universitetit të Tiranës.
2. Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u dha sot në datë 08.06.2015.

